

01.04.2020

 REPUBLIKA KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRË NE DOREZIM - PRIMLJENO - RECEIVED			
Nësia og. Org. Jezuikë Org. Unit	Numri Broj Number	Shtoja Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	351	16264	<i>[Signature]</i>



**REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKË
KONTRATË**

KOMUNA SUHAREKË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), te cilen e përfaqëson B Mustafë Buzhala zyrtar i Zyres se prokurimit dhe menaxheri i kontratës i/e caktuar me Aktvendim nga ZKA dhe në PMK nga njësia e kërkesës, në njérën anë dhe:

SAMIRE OSMANI B.I. p.n., - LESHANË –Suharekë NUI 811044247 të cilën e përfaqëson Samire Osmani, ne anën tjetër janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Titulli i kontratës

Dezinfektimi i objekteve shoqerore si Komuna QKMF QMF dhe AMF
Nr.prokurimit: 624-20-1064-2-3-5&6242 0015 235

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Shërbimet e Dezinfektimi i objekteve shoqerore si Komuna QKMF QMF dhe AMF, sipas specifikimit te detyrueshme te dhëna me dosje te tenderit me kuotim te çmimeve.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 01/04/2020 dhe përfundon në afat prej 5 dite siç eshte parapare me dosje te tenderit.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 1 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i kryerjes se shërbimit është në teritorin e Komunës se Suharekës sipas specifikimeve teknike te detyrueshme te aneksit 1 te dhënë me dosje te tenderit.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikzioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi**3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 4.864,00€ (Katër mijë e teteqind e gjashtedhjet e kater euro)**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vëtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro nga njësia e kërkesës. **Autoriteti Kontraktues do të lejoi pagesat, ku operatori ekonomik duhet te sjelle faturën për kryerje te shërbimeve dhe raportin e nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe menaxheri i kontratës nga njësia e kërkesës ne llogarin bakare te OE.**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 10 ditë, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të konratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas konratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkonratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të konratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik përvendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Konratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë konratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas konratës; b) Dështon në ekzekutimin e konratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt konratën apo nënkonratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* përmashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjeter ilegal që i dëmon interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimit të konratës.

Neni 12 Ndërprerja e Konratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë konratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me konratë; b) vazhdimesht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me konratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të konratës përmë shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në konratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **gjykatën kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës**.

Neni 14 Komunikimi


14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen *Shqipe* në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Kontakt numri i Operatorit ekonomik 045-661-343 Email: eko-pastrimi@outlook.com

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Samire Osmani	Emri:	Mustafë Buzhala
Pozita:	Përfaqësues	Pozita:	Zyrtar i zyres së prokurimit
Nënshkrimi:	<i>B. Gashi</i>	Nënshkrimi:	<i>J. H. Jashari</i>
Data:	01.04.2020	Data:	01.04.2020
Vula:		Vula:	vv






KOMUNA E SUHAREKES
OPSTINA SUHAREKE / MUNICIPALITY OF SUHAREKE
Drejtoria e Shendetesise dhe Mireqenjes Sociale

Paramasat per Sierbimet e Desinfektimit, ne Komune te Suharekes

Nr	Përshtatni	Njeza	Sasia	m2	Totali m2	Qmimi per m2	Totali
1	Desinfektimi i te gjitha objekteve kollative (indesave) e az komunen e Suharekë	m2	1	15200	15200	0.32 €	4 864.00 €
	Shuma Totale						4 864.00 €



✓
W